



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine
Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade
Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë

SKEMA E GRANTEVE PËR ENERGJI TË PASTËR – MASA 3

Udhëzues për aplikim: Thirrje publike për përkrahjen e bizneseve prodhuese - Mbështetje për pajisjet që ulin konsumin e energjisë në linjat e prodhimit – Masa 3.

Autoriteti zbatues: Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), respektivisht Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë (ME).

Autoriteti kontraktues: Agjencia e Luksemburgut për Bashkëpunim Zhvillimor (LuxDev).

1. Hyrje

MINT/KIESA, LuxDev dhe ME me datë 10.09.2025 kanë nënshkruar marrëveshjen për Skemën e granteve për Energji të Pastër . Qëllimi i kësaj skeme është të stimulojë angazhimin e sektorit privat në tranzicionin energjetik të Kosovës duke përdorur teknologji të qëndrueshme të prodhimit, duke rritur eficiencën e energjisë dhe duke ulur kostot operative.

Në këtë skemë ftohen Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme (NMVM) me aktivitete parësore ose dytësore në prodhim dhe përpunim të bëhen pjesë e Skemës së Granteve për Energji të Pastër. Përveç tyre, të drejtë aplikimi kanë edhe kompanitë e tjera që kanë hyrë në tregun e liberalizuar të energjisë elektrike me aktivitete parësore ose dytësore në prodhim dhe përpunim. Vlera totale e skemës është 1 milionë euro e financuar nga Qeveria e Dukatit të Madh të Luksemburgut.

2. Qëllimi

Skema e granteve për energji të pastër synon të mbështesë të gjitha Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme (NMVM¹) dhe bizneset e mëdha që kanë hyrë në tregun e liberalizuar të energjisë elektrike, me aktivitete parësore ose dytësore në prodhim dhe përpunim. Skema bashkëfinancon investime që përmirësojnë performancën energjetike dhe ulin kostot e energjisë elektrike përmes: (i) gjenerimit të energjisë së ripërtërishme (sistemet solare fotovoltaike dhe termike), (ii) ruajtjes të energjisë elektrike nga sistemet solare fotovoltaike përmes baterive, (iii) masave të eficiencës së energjisë në ndërtesat e bizneseve, dhe (iv) pajisjeve që ulin konsumin e energjisë në linjat e prodhimit

3. Sektori

- i. Të gjitha ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme prodhuese ose përpunuese kualifikohen² për aplikim. Gjithashtu, të gjitha kompanitë prodhuese ose përpunuese që nuk furnizohen më nga tarifa e rregulluar e energjisë elektrike, kualifikohen për këtë thirrje.

4. Masat e mbështetura në kuadër të Grant Skemës për Energji të Pastër

Skema e Granteve për Energji të Pastër zbatohet përmes tri thirrjeve të veçanta publike, të cilat përfshijnë masat e mëposhtme:

- Masa 1: Mbështetje për sistemet e energjisë solare dhe sistemet e baterive për ruajtjen e energjisë elektrike.
- Masa 2: Mbështetje për masat e efikasitetit të energjisë në ndërtesat e bizneseve.
- Masa 3: Mbështetje për pajisjet që ulin konsumin e energjisë në linjat e prodhimit.

Sqarim: Aplikuesit mund të aplikojnë për secilën nga tri Masat (Masa 1, 2 ose 3) individualisht, me një mbështetje maksimale deri në 20,000 € për secilën Masë të vetme. Masa 1 dhe 2 mund të kombinohen secila me Masën 3, por në këtë rast mbështetja totale nuk mund të kalojë vlerën prej 25,000 EUR. Megjithatë, përfituesit nuk mund të përfitojnë njëkohësisht nga Masa 1 dhe Masa 2.

5. Përkrahja financiare nga MINT/KIESA e ofruar për Masën 3

Masa 3 e Skemës së Granteve për Energji të Pastër mbështet investimet në pajisjet që ulin konsumin e energjisë në linjat e prodhimit: Inverter me frekuencë të ndryshme (shndërruesi frekuencor). Subvencionohet 70% e vlerës së pajisjes dhe deri në 65 €/kW duke përjashtuar kostot përcjellëse. Shuma maksimale e grantit është €20,000. Aplikuesit mund të kombinojnë Masën 3 me Masën 1 dhe Masën 2, por shuma maksimale e grantit nuk mund të kalojë €25,000.

6. Dokumentet e kërkuara sipas Udhëzimit Administrativ 01/2018

- Certifikatën e regjistrimit të biznesit me të gjitha informatat përcjellëse sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës.
- Certifikatën e numrit fiskal (nuk aplikohet për bizneset të cilat numrin e regjistrimit të biznesit dhe numrin fiskal e kanë në një certifikatë).
- Vërtetim tatimor me të cilën vërtetohet se aplikuesi nuk ka borxhe tatimore të pashlyera apo obligime tjera tatimore ose është në marrëveshje për shlyerjen e borxhit me ATK.
- Listën e punëtorëve për vitin 2024, të lëshuar nga ATK, me emrin e ndërmarrjes e në harmoni me NUI (mund të shkarkohet online nga ueb faqja e ATK-së). Në bazë të listës, do të kategorizohen dhe vlerësohen NMVM-të, si dhe do të vlerësohen piket e punësimit të gjinisë femërore.
- Kopjen e letërnjoftimit të personit/ve në emër të cilit/ve është i regjistruar aplikuesi.
- Dëshmi nga aplikuesi se nuk është në falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësor të lëshuar nga Gjykata Themelore - kërkohet origjinali jo më i vjetër se 30 ditë. Dokumenti mund të nxirret në Gjykatën Komerciale të Kosovës.
- Dëshminë e xhirollogarisë aktive në emër të biznesit aplikues në njërin prej bankave të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës. Dëshmia duhet të jetë brenda afatit të hapjes së thirrjes.
- Gjendjen e xhirollogarisë bankare në emër të biznesit aplikues për vitin e fundit (2024).
- Të mos ketë pranuar mjete nga burimet tjera të financimit për të njëjtat aktivitete (e dëshmuar me deklaratë nën betim, e cila duhet të shkarkohet nga ueb faqja e KIESA-se, të plotësohet me të dhënat e biznesit dhe e njëjta të ngarkohet në sistemin e-Kosova).

² Bazuar në Ligjin Nr. 04/L-220.

- Të kenë kryer të gjitha detyrimet nga mbështetja financiare paraprake, nëse kanë përfituar nga burimet publike të financimit nga MINT për dy vitet e fundit, (e dëshmuar me deklaratë nën betim, e cila duhet të shkarkohet nga ueb faqja e KIESA-se, të plotësohet me të dhënat e biznesit dhe e njëjta të ngarkohet në sistemin e-Kosova).
- Për ndërmarrjet e regjistruara para vitit 2023, duhet të sjellin qarkullimin për vitin 2023 dhe 2024 i dëshmuar me dokument të lëshuar nga ATK.
- Projekt-propozimin që përfshin: qëllimin, aktivitetet e projektit, koston financiare, planin kohor të realizimit të projektit, strukturën organizative të aplikuesit, ndikimin në performancën e ndërmarrjes, dhe aplikimin e energjisë së ripërtërishme dhe ekonomisë së gjelbër, duhet të shkarkohet nga webfaqja e KIESA-s, të përgatitet nga subjekti aplikues dhe të ngarkohet në platformën e-Kosova.
- Aplikacioni, duhet të plotësohet online në eKosova.

7. Dokumentet e kërkuara për plotësimin e kriterëve teknike sipas masave:

- Formulari Teknik – Shtojca 1 e këtij dokumenti.
- Fotografitë e etiketave që përmbajnë karakteristikat teknike të motorëve/makinerive ekzistuese dhe foto e motorëve/makinerive ekzistuese.
- Konsumi total i energjisë elektrike 2024 (EUR dhe kWh) (dokument nga furnizuesi KESCO ose furnizues të tjerë).

8. Dokumentet e kërkuara për pikë shtesë :

- Kontrata e furnizimit me energji elektrike për konsumatorët në treg të hapur.
- Certifikata e lindjes e pronarit, bashkëpronar-it ose udhëheqësit (përdoret për të vërtetuar se personi i regjistruar si pronar, bashkëpronar ose udhëheqës i kompanisë është grua).

Sqarim: Në mungesë të cilit do dokument të kërkuar më lartë, subjektet aplikuese do të diskualifikohen dhe nuk do të shqyrtohen për vlerësim.

9. Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e planifikuar e projektit të Grant Skemës për Energji të Pastër nuk mund të tejkalojë 12 muaj që nga hapja e thirrjes (përveç nëse ndryshe parashihet me kushtet e kontratës apo raportit të komisionit monitorues).

10. Sqarime shtesë

- Aplikacionet mund të plotësohen në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze.
- Të jetë i regjistruar si ndërmarrje e sektorit privat, nga 1 janari 2024 ose më herët, në përputhje me legjislacionin në fuqi në Kosovë.
- Ndërmarrja përfituese pas instalimit të pajisjes do të rimbursohet në bazë të pikës 3 të dhe 4 të këtij udhëzuesi.
- Në rast që ndërmarrja do të jetë përfitues, atëherë do të nënshkruhet marrëveshje dypalëshe, pjesë e secilës do të jenë edhe deklaratimet që janë bërë me rastin e aplikimit.
- Përfitues do të jenë ndërmarrjet që janë renditur me pikë më të larta nga komisioni vlerësues varësisht mjetëve të planifikuara.
- Në rast të ndonjë kostoje të paparashikuar që lidhet me zbatimin e propozimit, biznesi do të jetë përgjegjës për mbulimin e këtyre kostove.
- Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) është një shpenzim që nuk pranohet sipas kësaj Skeme për

kompanitë që deklarojnë TVSH-në.

- Nuk pranohen ndryshimet në ARBK nga momenti i hapjes së thirrjes dhe gjatë gjithë fazës së aplikimeve të thirrjes publike, si dhe për ndërmarrjet përfituese, pas shpalljes së listës preliminare deri te realizimi i pagesës.
- Në ueb të MINT/KIESA do të publikohet lista e ndërmarrjeve të vlerësuara.
- Përkrahën vetëm ndërmarrjet që aktivitetin primar dhe sekondar e kanë në sektorin e prodhimit dhe përpunimit.
- Aplikuesit kanë dy mundësi për të marrë grantin: përmes rimbursimit të plotë pas verifikimit përfundimtar, ose përmes një paradhënieje prej 50% të vlerës së grantit pas nënshkrimit të marrëveshjes, me kusht që të dorëzohet një garanci bankare për 50% të grantit, të lëshuar nga një Institucion Financiar i Regjistruar i licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës. Pjesa e mbetur prej 50% paguhet pas dorëzimit dhe miratimit të dokumentacionit të Fazës 2.

11. Si të aplikohet?

- Njoftimi për thirrje publike është i publikuar në ueb faqen zyrtare të MINT, KIESA dhe të ME:
 - <https://mint.rks-gov.net/>
 - <http://kiesa.rks-gov.net/>
 - <https://me.rks-gov.net/>

Aplikimi bëhet vetëm përmes platformës e-Kosova <https://ekosova.rks-gov.net/702>.

- Afati për aplikim: nga data 10.10.2025 deri më datë 09.12.2025.
- Informatat shtesë mund të merren përmes email adresës: sme.kiesa@rks-gov.net

12. Kriteret e vlerësimit

Përparësi do t'u ofrohet ndërmarrjeve më të prekura nga tregu i hapur i energjisë elektrike, projektet e të cilave synojnë të rrisin eficiencën e energjisë dhe përdorimin e energjisë së ripërtërishme.

Sistemi i pikëve është si vijon:

#	5. Kriteret e vlerësimit	Pikët maksimale
1	Ekspozimi ndaj çmimeve të energjisë elektrike të bazuara në treg	deri në 45 pikë
2	Intensiteti i energjisë (elektrike)	deri në 20 pikë
3	Ndikimi i Energjisë (elektrike)	deri në 20 pikë
4	Përfshirja Sociale: Kompania: (a) është në pronësi, në bashkëpronësi ose udhëhiqet nga një grua (në pronësi ose bashkëpronësi), (5 pikë) (b) është në pronësi, në bashkëpronësi ose udhëhiqet nga minoritetet, (5 pikë) (c) punëson një numër të konsiderueshëm grash (të paktën 30% e stafit të përgjithshëm) (5 pikë)	deri në 15 pikë
#	Totali	deri në 100 pikë

13. Ankesat

Pas publikimit të rezultateve preliminare aplikuesit mund të adresojnë ankesa brenda afatit të paraparë me UA 01/2018, në platformën e-Kosova.

Shënim:

Në rast se informatat e dhëna në këtë aplikacion vërtetohen që janë të pa sakta, subjektit nuk do t'i realizohet pagesa dhe i njëjti do të mbajë përgjegjësi për të gjitha pasojat, sipas legjislacioneve relevante në fuqi.